



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.107, datë 30.10.2020

PËR

**VIJIMIN E PROÇEDURAVE TË PRISHJES SË DETYRUAR TË 1 (NJË) NDËRTESE (PALLAT) PRIVATE TË NDODHUR NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.4 DURRËS, NË ZBATIM TË EKSPERTIZËS SË THELLUAR TË HARTUAR NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT, TIRANË**

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” miratuar me Ligjin nr. 97/2019, VKM nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përsheptuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësive natyrore”, dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK  
VENDOSI:**

1. Vijimin e procedurës të prishjes së detyruar të 1 (një) ndërtese (pallat) private, të ndodhur në Njësinë Administrative nr. 4, në zbatim të ekspertizës së thelluar të hartuara nga Instituti i Ndërtimit Tiranë si me poshtë vijon:

NR	PROT/DATË	OBJEKTE	Nr. KATI	ADRESA	GIS	KONKLUZIONI	NJËSIA ADMINISTRATIVE
1	PROT 12075 DATA 01.10.2020 NR PROT INST 2339	NDERTESA NR. 19	5 kate	Rruga Doktor Spiro Treska	21395	PRISHJE	RAJONI 4

2. Zëvendëskryetari i Bashkisë, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit ndjekin procedurat për aplikimin, shqyrtimin dhe miratimin e dokumentit për leje ndërtimi (prishjen e objektit të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore), sipas parashikimeve të vendimit nr. 887/2019, të Këshillit të Ministrave.
3. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit merr të gjitha masat për ndërhyrjen dhe prishjen e objektit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.
4. Me qëllim njoftimin e banorëve dhe palëve të interesuara, vendimi publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës, si dhe afishohet në stendat publike pranë njësisë administrative nr. 4.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Zëvendëskryetari i Bashkisë, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Durrës dhe Drejtoria e Kabinetit.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

**KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**




**U shpall sot me datë 30.10.2020**

LISTA E PALLATEVE PER PRISHJE NJESIA ADMINISTRATIVE 4												
Nr.	NJESIA / RAJONI (NR. KATI)	ADRESA	KODICIS	PRISHJERFORCIM	ZHKADASTRALE	NR.PAS	SIPANJOLLA / m2	MR.FAMILIJE	AP. 3+1	AP. 2+1	AP. 1+1	PROTDATE
<b>R-4</b>	<b>RAJONI 4</b>	<b>5 KT 19   DOKTOR SPIRO TRESKA</b>	<b>1 388</b>	<b>PER TU PRISHUR</b>	<b>RE11</b>	<b>4/146 4/31 4/154</b>	<b>568</b>					
		3 / 458			3 / 538							
		3 / 302										
		3 / 319										
		3 / 482										
		3 / 561										
		3 / 500										
		3 / 301										
		3 / 298										
		2 / 371										




RRUGA TE LAT MOGA ( KASTRIOTI )



PER PRISHJE

DOKTOR SPIRO TRESKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 992 prot.  
16

Durrës, më 04.11 .2020



**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK**

**DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.107 datë 30.10.2020 “Për vijimin e procedurave të prishjes së detyruar të 1 (një) ndërtese (pallat) private të ndodhur në njësinë administrative nr. 4 Durrës, në zbatim të ekspertizës së thelluar të hartuar nga Instituti i Ndërtimit Tiranë”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që më jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**ROLAND NASIO**

